



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:125795
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06573626

Pml.nr.736/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve: N. G. dhe Q. G., që të dy nga fshati ..., komuna e L., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 327, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit Q. G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.462/2018, datë 24.01.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.641/2024, datë 27.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 05.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit Q. G. dhe sipas detyrës zyrtare për të dënuarin N. G., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.462/2018, datë 24.01.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.641/2024, datë 27.06.2024, ashtu që çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.462/2018, datë 24.01.2024, të dënuarit: N. G. dhe Q. G., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 327, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ndaj secilit prej të dënuarve është shqiptuar dënim me kusht, ashtu që është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet,

nëse në afat prej dy (2) vjetëve, të njëjtit nuk kryejnë ndonjë veprë penale tjetër. Dënimi me kusht është shqiptuar me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues, konform nenit 58 të KPRK-së.

Secili nga të dënuarit janë detyruar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej nga dyzetë (40) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.641/2024, datë 27.06.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit Q. G., avokatja Kimete Sahiti, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptoj një dënim më të butë apo i dënuari të lirohet nga akuza, ose t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që çështja penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.419/2024, datë 02.12.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit Q.G.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësja e të dënuarit Q. G., pretendon se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që me aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë dhënë arsye të qëndrueshme dhe bindëse në lidhje me ekzistimin e veprës penale dhe faktit se kryerës i saj është i mbrojturi i saj, gjithnjë duke e pasur parasysh se as pala e dëmtuar – prifti M. P., nuk ka arritur që të definoi kryesin e veprës penale dhe se vazhdimisht në deklaratat e tij ka theksuar se nuk ka njohuri se kush mund ta ketë kryer veprën penale. Gjithashtu, edhe dëshmitari N. Q., ka thënë se nuk e di kush e ka kryer veprën penale dhe se nuk dyshon në askënd, ndërsa të njëjtën gjë e ka dëshmuar edhe dëshmitari tjetër P. G. E tërë aktakuza, është mbështetur vetëm në një provë dhe atë në deklaratën e dëshmitarit/ të miturit M.Sh., të dhënë në Policinë e Kosovës, i cili gjatë më pastaj, në seancën gjyqësore të datës 27.12.2023, në Departamentin për të Mitur e kishte mohuar një deklaratë të tillë. Në anën tjetër, nga raporti

i vendit të ngjarjes nuk është gjetur ndonjë gjurmë e gishtërinjve apo ndonjë provë tjetër penale që do të ndërlidhej me të dënuarit, të cilët e kanë mohuar kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjykata Supreme e Kosovës pas i shikoi dhe analizoi të gjitha shkesat e lëndës ka ardhur në përfundim se pretendimet e mbrojtëses të të dënuarit Q. G. janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7, lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së, ndërsa këto shkelje, për shkak të natyrës së tyre, kanë ndikuar në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij aktgjykimi.

Në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”, kurse në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që në pjesën e arsyetimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme për të gjitha pika e aktgjykimit, si dhe nuk janë vlerësuar dhe arsyetuar në mënyrën e duhur provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe në të nuk janë paraqitur në mënyrën e duhur provat, duke përfshirë këtu edhe provat materiale, që janë marrë për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale dhe gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar dhe vlerësuar provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se “Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”. Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundime nëse faktet e caktuara janë vërtetuar apo jo.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerëson edhe saktësinë e provave kundërthënëse, ndërsa më pastaj të nxjerrë konkluzione të caktuara në lidhje me këtë çështje penale.

Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, jo vetëm që është i mangët dhe i pakuptueshëm sa i përket çështjeve të lartcekura, por në pjesën dërmuese të tij, sidomos pjesa e paraqitjes së përmbajtjes së provave, është një përshkrim, përkatësisht kopjim në mënyrë detale i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

Nga kjo pjesë e arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që është përshkruar në tërësi procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, duke i përshkruar në tërësi edhe pyetjet që janë parashtruar ndaj dëshmitarëve nga prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo mënyrë e shkrimit të arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e përshkruar në tërësi procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor (ndryshe e ashtuquajtur metodë “*copy-paste*”), nuk është në harmoni me dispozitat e lartcekura ligjore, andaj edhe si e tillë është e papranueshme.

Gjithashtu, në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitura arsye të qarta se mbi bazën e cilave prova konkrete është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i dënuari Q. G., ta ketë kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke administruar sërish të gjitha provat, ndërsa më pastaj, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në nenin 397 dhe në nenin 436, paragrafi 2 të KPP-së (“Beneficium Cohesionis”), sipas detyrës zyrtare vendosi edhe në dobi të të dënuarit N. G., edhe pse i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, pasi që arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të dënuarit Q. G., nuk janë të natyrës personale.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. lidhur me nenin 436, paragrafi 2 të KPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.736/2024, datë 05.12.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi